KËRKESË
Nr. 117/7, datë 21.4.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësimin dhe/ose për shkëmbimin e pronës për interes publik, që preken nga projekti "Ndërtimi i godinës së kopshtit publik Vorë", Bashkia Vorë.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Bashkia Vorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

2. Për pasuritë e llojit "apartament" dhe "ndërtesë" me funksion banimi, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, bazuar në çmimet mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit, për vitin 2016.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Bashkisë Vorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 1 425 312 (një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE SHKËMBIMIT
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "RINDËRTIM I GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK VORË", BASHKIA VORË

| No. | a | | |